

Protesta e Autoveturave 8+1. Ditë tensionesh dhe deklarimesh kontraditore të Qeverisë. BSPSH mbështetje maksimale për punonjësit e transportit.

Elbasan, Mblidhet Konferenca e Jashtzakonshme e Sindikatës së Pavarur të autoveturave 8 + 1 anëtare e BSPSH. Tubim pa dallim bindjesh politike dhe sindikale.



Rreth 1000 drejtues të furgonave 8 + 1 nga e gjithë Shqipëria janë mbledhur më 18 shkurt në qytetin e Elbasanit në Konferencën e Jashtzakonshme të Sindikatës së Pavarur të autoveturave 8 + 1 , anëtare e BSPSH.

Ftesës për pjesëmarrje në këtë takim iu përgjigj vetëm deputeti i PD Luciano Boçi.

Me radhë përfaqësues të rretheve të Shqipërisë paraqitën shqetësimet e tyre në lidhje me situatën e krijuar. Pasi ka dëgjuar me radhë përfaqësuesit e rretheve kryesore e ka marrë fjalën presidenti i BSPSH Gëzim Kalaja

Fjala e Presidentit të BSPSH Gëzim Kalaja



Sot nuk do të mungoja për asnjë arsye siç e cilësuat dhe ju në këtë kuvend dhe siç deklaroi

përfaqësuesi i Shkodrës që i kalon përmasat e Kuvendit të Prizrenit. Kjo është një domethënie e madhe se sot në këtë sallë janë bashkuar sot më shumë se kurrë të gjithë njerëzit me bindje të ndryshme politike por me një qëllim të vetëm bashkë me BSPSH për t'i thënë qeverisë shqiptare, Kryeministrit, Ministrit të Transportit dhe Ministrit të Brendshëm të tërheqin menjëherë udhëzimin dhe vendimin që kanë dhënë për bllokimin e autoveturave 8 +1 që të mos lëvizin në arteriet e kombit shqiptar. Kërkesës tuaj iu përgjigj BSPSH që prapa i vjen historia. I kam dëgjuar me shumë vëmendje përfaqësuesit tuaj në këtë tribunë të nderuar. Sot këtu mund të ishin me mijra. Ne kemi ardhur këtu për të marrë një vendim të rëndësishëm për t'i thënë opinionit publik, politikës, qeverisë shqiptare se sindikata është në këmbë për mbrojtjen e interesave të punonjësve të Shqipërisë dhe qytetarëve të Shqipërisë. Ftoj deputetët pa asnjë dallim që të ngrihen në këmbë kur përmendet emri juaj, sepse për 18 vjet ju mbajtët të gjallë shpirtin e qytetarëve shqiptarë, ju bëtë të mundur shpëtimin e njerëzve të cilët kërkonin urgjencën për t'u mjekuar në spitalet e Tiranës dhe gjithë Shqipërisë. Ju dhatë kontribut gjatë luftës së Kosovës. Përballë këtij kontributi, qeveria dhe kombi duhet të përulet me respekt. Asnjë qeveri nuk mundet dot t'i privojnë të drejtën shqiptarëve për të jetuar. është në detyrën e saj kushtetuese që çdo qytetari të këtij vendi t'i sigurojë vendin e punës, për të patur të mira materiale, për të mbajtur familjen e tij. Do t'i bëja një pyetje kryeministrit dhe jam i gatshëm të përballem në çdo studio me të dhe me çdo ministër se a e ka menduar strategjinë se ku do t'i punësojë këto 20 mijë burra që mbajnë 100 mijë vetë me shpatullat e tyre pasi të heqë autoveturat 8 +1?. A do të mundet dot t'ua kthejë qeveria kreditë dhe borxhet që kanë marrë? A do të mundet dot qeveria tu japë vende të reja pune që ju të keni paga dinjitoze për të mbajtur familjet tuaja? A do të mundet dot t'u sigurojë studentëve, të rinjëve dhe të rejave, bijave dhe djemve tanë paraqitjen në kohën e duhur në dyert e universiteteve? Kam ftuar këtu sot deputetët e rrethit të Elbasanit. Sot kam ftuar edhe ministrin Haxhinasto i cili më 12 shkurt nuk kishte mbledhur në takim grupet e interesit, por në fakt kishte mbledhur grupet e monopoleve e them këtë se fjala e dy ministrave Tahiri dhe Haxhinasto ishte për të pushkatuar autoveturat 8+1 dhe për t'i lënë krahun e lirë autobuzëve. Unë si president i BSPSH-së jam që të gjithë të punonjë në hapësirën shqiptare, sepse ka vend për të gjithë. Nesër kam një takim me ministrin Haxhinasto. Ne do ta respektojmë takimin, sepse në strategjinë tonë është dialogu social. Z. Boçi do t'i kërkoja lobing në Parlamentin Shqiptarë për të mirën tuaj dhe të gjithë shqiptarëve. Jam shumë i sigurt që dhe pjesa dërmuese e deputetëve të PS janë me ju, por nuk mund të deklarohen. Do të ishte mirë që të respektonin votën që i keni dhënë, ju dhe ata që janë jashtë sallës dhe gjithë qytetarët shqiptarë.. I kërkoj dhe një herë kryeministrit Edi Rama të respektojë fjalën e tij të mbajtur në Parlament në të cilën thotë “deri në këtë sekond që po flas nuk kemi urdhëruar të ndalohen autoveturat 8 + 1 që janë me licensë”, ndërsa ministat Tahiri dhe Haxhinasto dalin me ultimatumin që të ndalohen autoveturat. Në përputhje me ligjin ne kërkojmë ardhjen plot dhe kthimin plot me pasagjerë dhe luftën kundër informalitetit Ne jemi për paqe dhe pakt social, mos na zgjoni nga gjumi, kur nuk ua kërkojmë. Protestat tuaja janë bërë në mënyrë sporadike, por në qoftë se do të na imponohet të cilët ne nuk e dëshirojmë, do të zhvillohet një protestë e transportit shqiptar e paparë në historinë e këtyre viteve.